



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM
Nr 59 Datë 21.7.09

PER NDRYSHIMIN E PAGAVE TE PUNONJESVE TE QKR SIPAS VKM NR.
598 DATE 27.04.2009

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës «Për ndryshimin e pagave të punonjësve të QKR sipas VKM nr. 598 datë 27.04.2009», bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, në ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në ligjin nr 10025 dt. 27.11.2008, «Për buxhetin e vitit 2009», në Udhëzimin e MF nr 2 dt. 12.01.2009 «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009» në VKB nr 12 dt 13.02.2009 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009», VKB nr. 4 datë 06.02.2009. VKM nr. 700 datë 18.06.2009 si dhe VKM nr. 598 datë 27.04.2009.mbështetur në kompetencat që ka si dhe me propozim të anëtarëve:

VENDOSI

1.Të miratojë ndryshimin e fondit të pagave nga 924,180 lekë në 954,680 lekë si dhe ndryshimin e fondit të sigurimeve shoqërore nga 200,544 lekë në 170,044 lekë si më poshtë:

Grupi	Titulli	Kapitulli	Muaji	Shtesa 600	Pakësime 601
04	04130	08	Gusht	30,500	
04	04130	08	Nëntor		13,788
04	04130	08	Dhjetor		16,712
			Total	30,500	30,500

2. Efektet financiare fillojnë në 01.05.2009.

3.Te miratoje rritjen e pagave te punonjesve ne masen 5%.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkiv dhe Shërbimeve Mbështetëse.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Gjergji Pendavinji